



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 46300/24

Nr. i fq. / Br. st. 4-

Data: / Datum: 17.09.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vuçitrn-Municipality of Vushtrri

---

**Procesverbali nga dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kryesuesja e  
Kuvendit për projekt buxhetin e Komunës për vitin 2025**

**Shtator 2024**

## PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik me qytetarë për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2025-2027, i organizuar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

**Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës**

**Ora: 14:00**

**Data: 13.09.2024**

Të pranishëm nga Komuna ishin: Melihate Basholli Latifi, kryesuese e Kuvendit të Komunës, Isuf Jashari, drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar.

**Melihate Basholli Latifi, kryesuese e Kuvendit**, hapi takimin me qytetarë ku falënderoi të gjithë të pranishmit që janë bërë pjesë aktive e përgatitjes së buxhetit për vitin 2025.

**Isuf Jashari, drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar**, përshëndeti të pranishmit dhe para tyre paraqiti buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.

Gjithashtu, qytetarëve pjesëmarrës në këtë takim ju është ndarë materiali i buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025 në mënyrë që të jenë të informuar.

Më pas fjala ka kaluar tek qytetarët pjesëmarrës në këtë takim për të paraqitur kërkesat e tyre.

**Vildane Mulaku, përfaqësuese e shoqatës “Martirët e Lirisë 98-99”**, theksoi se është e rëndësishme e pjesëmarrja e grave në dëgjimet publike për planifikimin e buxheti, dhe në këtë takim tregoi se si në dëgjimet publike si ky si sodit ka kërkuar rregullimin e varrezave në Studime dhe projekti është duke u finalizuar.

**Xhavit Haziri, nga Vushtrria**, paraqiti disa kërkesa, si rruga “Isak Halili” të asfaltohet, si dhe për fshatit Druar u interesua për kanalizimin nga shkolla deri te rruga “Martirët e Qyqavicës”.

**Blerim Ibrahim, përfaqësues i shoqërisë civile**, ngriti çështjen e personave me aftësi të kufizuara, ku kërkesat i ka dorëzuar në mënyrë elektronik, e të cilat janë:

### **Problemet kyçe:**

- Qasje e pamjaftueshme në infrastrukturë, informim, kulturë, sport dhe shërbime të tjera për personat me aftësi të kufizuara;
- Mungesa e interpretëve të gjuhës së shenjave në institucionet komunale, që pengon komunikimin e qartë dhe përfshirjen për personat me dëgjim të kufizuar;
- Shenja dhe tabela të pamjaftueshme në alfabetin e Brajlit për personat e verbër, që kufizon qasjen e tyre në informim dhe shërbime;
- Mungesa e shërbimeve shëndetësore dhe sociale të specializuara, duke përfshirë terapinë fizike dhe psikologjike, si dhe mbështetjen për kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara;
- Personat me aftësi të kufizuara nuk konsultohen dhe përfshihen në mënyrë të vazhdueshme në proceset vendimmarrëse;

- Kostot e larta të lidhura me rregullimin e infrastrukturës shtëpiake (p.sh., banjo, dhoma) për të akomoduar nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

#### **Çështjet për adresim:**

- Përmirësimi i qasjes në infrastrukturë, informim, kulturë, sport dhe shërbime të tjera për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me standardet e përshtatshme;
- Angazhimi i interpretëve të gjuhës së shenjave në të gjitha institucionet komunale për të siguruar komunikim të qartë dhe përfshirje të plotë për personat me dëgjim të kufizuar;
- Vendosja ose rregullimi i shenjave dhe tabelave sipas alfabetit të Brajlit për personat e verbër;
- Sigurimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale të specializuara, përfshirë terapinë fizike dhe psikologjike, dhe mbështetje për kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara;
- Konsultimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në proceset vendimmarrëse dhe organizimi i konsultimeve të rregullta me organizatat që i përfaqësojnë ata;
- Subvencionimi për rregullimet e infrastrukturës shtëpiake (p.sh., banjo, dhoma) që kanë një kosto të përballueshme.

#### **Hartëzimi i adresimit:**

- Në procesin e hartimit të projekteve të investimeve kapitale, të kryhet një vlerësim i investimeve nga këndi i nevojave të personave me aftësi të kufizuara;
- Të planifikohet linjë e veçantë e investimeve kapitale, për përmirësimin e infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara;
- Të rekrutohen staf për mbështetjen në ofrimin e shërbimeve, për personat me nevoja të veçanta, apo të krijohet një hapësirë e veçantë e konsultimit dhe asistence në ofrimin e shërbimeve, me qasje të lehtë brenda institucioneve komunale.
- Të kryhet një vlerësim i nevojave (të analizohen të dhënat nga regjistrimi i ri, të mblidhen të dhëna nga numri i ofrimit të shërbimeve) për numrin e shërbimeve sociale, si dhe të bëhet kostimi i shërbimeve sociale;
- Të planifikohet financimi i shërbimeve sociale, të analizohen format e financimit (subvencionimi i organizatave të specializuara si HANDIKOS), apo të planifikohet kontraktim i shërbimeve sociale;
- Krijimi i një plani të veçantë të shtrirjes (outreach plan) për konsultimet me personat me nevoja të veçanta, duke marrë në konsideratë kufizimet dhe nevojat e tyre;
- Të planifikohet financim (subvencionim) për mbështetjen e familjeve të personave me aftësi të kufizuara, për përmirësimin e infrastrukturës shtëpiake, si hyrjet e shtëpive, banjot si dhe pjesë tjera të infrastrukturës;

**Shemsije Maloku, nga Vushtrria**, kërkoj që Komuna të mbështet realizimin e një ekskursioni për fëmijët me sindromën Down.

**Nazmi Osmani, nga fshati Bukosh**, kërkoj që të asfaltohet rruga “4 Martirët”.

**Fikrije Ferizi, nga shoqëria civile, kërkoi që të ndahet buxhet për renovimin e objektit ku gjenden shoqatat.**

Takimi përfundoi në ora 15:00.

Procesmbajtëse:

Remzije Zekolli





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Vushtrrisë  
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Lista e pjesëmarrësve

Konsultimi publik me qytetarë për buxhetin e vitit 2025 organizuar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Datë: 13.09.2024

Ora: 14:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Blerim Ibrahim	Blerim	Vushtrri
2	Vëloane Maloku	Vëloane	Vushtrri
3	Myrte Jemili	Myrte	Motonej
4	Romirë Bekali	Romirë	Nurthi
5	Bedrija Maxhuni	Bedrija	Maxhunaj
6	Shkënte Zekolli	Shkënte	Maxhunaj
7	Xhavit Haziri	Xhavit	Vushtrri
8	Leonida Osmani	Leonida	Vushtrri
9	Hazmi Osmani	Hazmi	Burosh
10	Zyrafete Zekolli	Zyrafete	Vushtrri
11	Feriz Ferizi	Feriz	Vushtrri
12	Feriz Ferizi	Feriz	Vushtrri
13	Shemsije Maloku	Shemsije	Vushtrri
14	Jadete Januzi	Jadete	Vushtrri
15	Nasrime Aliu	Nasrime	STROVC



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Vushtrrisë  
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Lista e pjesëmarrësve

Konsultimi publik me qytetarë për buxhetin e vitit 2025 organizuar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Datë: 13.09.2024

Ora: 14:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
16	Mergim Smokelli		Dolak
17	Xhavit Mehmeti		Vushtrri
18	Esat Vahoreci		Vushtrri
19	Berut Maxhuni		Vushtrri
20	Donjetë Latifi		Pestovë
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			